

# Imigrim familjar

Kur një anëtar i familjes Suaj jeton në Norvegji, apo nëse dëshironi të krijoni familje me një person që jeton këtu, mund të kërkonit leje për imigrim familjar, për të ardhur këtu dhe për të banuar bashkë me atë.

Personi që banon në Norvegji duhet të jetë shtetas norvegjez ose shtetas nordik, ose duhet të ketë leje qëndrimi të përhershme (kjo leje quhej më herët leje për vendosje), ose leje qëndrimi që është bazë për leje qëndrimi të përhershme.

## Cilët anëtarë të familjes së afërt kanë të drejtën e lejes për imigrim familjar?

- bashkëshort/e ose partner i regjistruar.
- bashkëjetues/e gjatë dy viteve.
- bashkëjetuesë që kanë fëmijë të përbashkët (edhe kur nuk keni qenë bashkëjetues për dy vite).
- Fëmijë nën moshën 18 vjeçare.
- Prindër me përgjegjësi të përditshme për fëmijë norvegjez, ose
- prindër që kanë të drejtën e vizitës me fëmijë në Norvegji.

## Cilët anëtarë tjerë të familjes mund të marrin leje për imigrim familjar?

- Një person që do të martohet me personin që banon në Norvegji, brenda gjashtë muajve pas hyrjes në Norvegji.
- Nënë ose baba më i moshuar se 60 vjeç, pa familje të afërt në vendlindje.
- Bashkëjetues që presin fëmijë bashkë.
- Fëmijë i mbajtur më se 18 vjeç, i pamartuar dhe pa bashkëjetues/e, që ka mbetur në vendlindje kur anëtarët tjerë të familjes marrin leje qëndrimi në Norvegji.
- Motër dhe vëllezër nga të njejtët prindër që mbesin jetim dhe që nuk kanë persona tjera që mund të kujdesen për ata në vendlindje ose në vendin ku qëndrojnë.

## Kushtet ekonomike për jetesë dhe banesë (kushtet e mbajtjes)

Si rregull kryesore, personi në Norvegji duhet të jetë në gjendje që të kujdeset ekonomikisht për Ju në Norvegji. Kjo do të thotë që personi në Norvegji duhet të ketë të ardhura prej më së pakti 225 400 korona norvegjeze në vjet para tatimeve (prej 1. Qershor 2010). Është kusht edhe që personi të ketë fituar po aq edhe vitin më herët. Gjithashtu, personi në Norvegji nuk duhet të ketë marrë ndihmë sociale gjatë vitit të fundit.

Kur kërkuesi nuk është anëtar i afërt i familjes së personit në Norvegji (shikoni rubrikat më lartë) është kusht që ai/ajo të disponojë banesë për Ju në Norvegji.

## Katër vite punë ose arsimim në Norvegji janë kusht

Kur personi në Norvegji është imigrant, mund të jetë një kusht që ai/ajo të ketë punuar ose studjuar për katër vite me kohë të plotë në Norvegji. Kjo vlen për rastet kur jeni i fejuari/ja, bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja, ose pritni fëmijë me personin në Norvegji, dhe keni themeluar familje pasi personi që banon në Norvegji ka ardhur në Norvegji. Ky kusht nuk vlen në qoftë se personi në Norvegji është norvegjez ose e ka fituar shtetësinë norvegjeze apo nordike.

## Ç'farë dokumentimi duhet t'i bashkëngjis kërkesës?

Kushtet për dokumentim mund të ndryshojnë nga shteti në shtet dhe mund të ndryshojnë me kohë. Duhet të kontrolloni kushtet më hollësisht Ju vet pranë ambasadës ose konsullatit norvegjez në vendin prej ku kërkonit.

Ndër tjerë duhet të bashkëngjitni:

- formular kërkesë të plotësuar krejtësisht me nënshkrimin Tuaj
- certifikatin Tuaj të lindjes
- kopje të gjithë faqeve të pasaportës (edhe të faqeve të papërdorura)
- dokumentim të farestisnisë me personin që banon në Norvegji
- dokumentim që personi që banon në Norvegji ka mundësi që të Ju mbajë ekonomikisht
- dokumentim që personi në Norvegji ka vend ku mund të banoni (për shembull kontratë qiraje ose kontratë të blerjes së shtëpisë)
- dokumentim që personi në Norvegji ka punuar ose studjuar më së pakti katër vite në Norvegji (në qoftë se ky kusht vlen për rastin Tuaj)
- fotografi për pasaportë/fotografi

Përveç këtyre mund të ketë edhe kushte tjerë për disa kërkesues. Ambasada ose policia ka informata se ç'farë dokumentimi është i nevojshëm për secilën kërkesë.

Dokumentimi që bashkëngjitni duhet të jetë origjinal ose kopje e vërtetuar nga një autoritet zyrtar, pos rasteve ku nuk ka specifikim tjetër.

Gjithë dokumentet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën norvegjeze ose angleze nga një përkthyes i autorizuar.

### **Ku duhet t'a bëj kërkesën?**

Kur kërkonti leje për imigrim familjar, kërkesën duhet t'a dorëzoni në ambasadën ose në konsullatin norvegjez në shtetin ku banoni ose në vendin ku keni qëndruar gjashtë muajt e fundit.

## **Pyetje të zakonshme**

### **Sa kohë merr shqyrtimi i kërkesës?**

Informacionin mbi kohën e shqyrtimit e gjeni në [www.udi.no/saksbehandlingstider](http://www.udi.no/saksbehandlingstider) apo duke kontaktuar UDI-n. Edhe ambasada norvegjeze mund të Ju japë informacion mbi kohën e shqyrtimit.

Është e rëndësishme që formulari i kërkesës të jetë i plotësuar dhe që dokumentimi i nevojshëm të jetë bashkëngjitur për të siguruar që të mos ketë zgjatje të panevojshme të kohës së shqyrtimit.

### **A mund të shkoj në Norvegji para se të miratohet kërkesa për imigrim familjar?**

Zakonisht nuk mund të hyni në Norvegji para se të miratohet leja. Në rastet që nuk keni nevojë për vizë mund të shkoni prapëseprapë në Norvegji dhe kërkesën mund t'a bëni atje. Rast i këtillë mund të jetë në qoftë se, për shembull, jeni bashkëshort/e ose keni bashkëjetuar më se dy vite, ose bashkëjetoni me personin që ka fëmijë ose pret fëmijë në Norvegji. Personi në Norvegji duhet të jetë shtetas norvegjez ose nordik, ose duhet të ketë leje qëndrimi të përhershme ose leje qëndrimi që mund të jetë bazë për leje qëndrimi të përhershme.

Në shumicën e rasteve edhe fëmija që keni me bashkëshortin/en Tuaj (që banon në Norvegji) dhe që nuk është shtetas norvegjez mund të bëjë kërkesën nga Norvegjia. Kjo vlen edhe për fëmijë që keni nga lidhje më të herëta në qoftë se mund të dokumentoni që jeni i vetmi që keni përgjegjësinë prindore ose që keni leje nga prindi tjetër i fëmijës për vendosjen e fëmijës në Norvegji. Në qoftë se keni ndonjë dyshim a mund të udhëtoni Ju ose fëmija Juaj në Norvegji para miratimit të kërkesës, duhet t'i drejtoheni [ambasadës norvegjeze](#) më të afërt ose duhet të kontaktoni me UDI-n.

### **A kushton diçka kërkesa për imigrim familjar?**

Po, kërkesa për imigrim familjar ka taksë. Taksa paguhet në polici ose në ambasadë kur e dorëzoni kërkesën.

Fëmijë nën moshën 18 vjeçare nuk paguajnë taksë. Për shumën e përditësuar të taksës shikoni faqet e Internetit të UDI-s ose kontaktoni stacionin norvegjez më të afërt për punë të jashtme. Taksën mund t'a paguani me para në dorë ose me kartë bankare. Taksa mund të paguhet edhe paraprakisht (me mbartje llogaritare). Në atë rast vërtetimin duhet t'a bashkëngjitur kërkesës kur e dërgoni me postë apo kur e dorëzoni vet. Numrin e llogarisë e merrni nga policia ose nga ambasada

### **A mund të marr leje imigrimi familjar kur anëtar i familjes teme në Norvegji ka një leje qëndrimi që nuk është bazë për leje qëndrimi të përhershme?**

Po. Por kjo vlen vetëm për bashkëshort/e, bashkëjetues/e dhe fëmijë. Leja e qëndrimit e personit në Norvegji tregon a përmban leja e tij/saj bazë për imigrim familjar.

### **A duhet ta përtëris kërkesën për qëndrim dhe punë kur atë e kam marrë bazuar në imigrim familjar?**

Leja e imigrimit familjar jepet zakonisht për nga një vjet. Ka rëndësi që kërkesën e përtëritjes t'a dorëzoni një muaj para se të skadojë afati i lejes. Duhet të paguani taksë për përtëritjen e lejes (fëmijët më të rinj se 18 vjet nuk kanë detyrim pagese). Pas tre viteve mund të kërkonti leje qëndrimi të përhershme.

### **A kam mundësi të ankohe kundër mohimit të kërkesës?**

Po. Në rast ankese, ankesa shqyrtohet nga UDI-ja, dhe në qoftë se UDI-ja nuk e ndryshon vendimin, atëherë shqyrtimi bëhet nga Gjykata për të Huajt (UNE). Shqyrtimi i ankesës është falas.

A mbulohen shpenzimet e udhëtimit për anëtarët e familjes që marrin leje për imigrim familjar? Zakonisht jo. Vetëm persona që kanë marrë azil ose status si refugjatë kalimtarë në Norvegji dhe që kanë të ardhura të pakta ose që nuk kanë të ardhura mund të fitojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për anëtarë të familjes.

### **A dëshironi të keni informacione më të hollësishme mbi imigrimin familjar në Norvegji?**

Në qoftë se dëshironi të njoftoheni më hollësisht mbi imigrimin familjar mund të kontaktoni stacionin më të afërt norvegjez për punë të jashtme. Në qoftë se gjendeni në Norvegji mund të kontaktoni UDI-n. Shikoni informacioni për kontakte mëposhtë.

Utlendingsdirektoratet (UDI)

Postboks 8108 Dep.

N-0032 Oslo

Kontoradresse: Hausmannsgate 21

Sist oppdatert: 15.02.2011

Telefon: (+47) 23 35 15 00

Faks: (+47) 23 35 15 15

[www.udi.no](http://www.udi.no)

E-post: [udi@udi.no](mailto:udi@udi.no)

**UDI**  
Utlendingsdirektoratet